



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1686, datë 19.09.2011**

**Për**

**“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.09.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc Dega në Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;

4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit Unifi Holdings me nr. 987 Prot., i AKEP, datë 21.06.2011, “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings dhe Eagle Mobile sh.a.*”;
  - Shkresa e Unifi Holdings me nr. 124 Prot. i AKEP, datë 28.1.2011;
  - Shkresa e Eagle Mobile sh.a., me nr. 502 Prot., datë 8.02.2011, ku i përgjigjet Unifi Holdings;
  - Shkresa e Unifi Holdings datës 12.04.2011, drejtuar Eagle Mobile sh.a.;
  - Shkresën Eagle Mobile sh.a., me nr. 1528 Prot., datë 18.04.2011, ku i përgjigjet Unifi Holdings;
  - Shkresën e Unifi Holdings e datës 12.05.2011, ku i përgjigjet Eagle Mobile sh.a.;
  - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
  - si dhe,
- duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## **V Ë R E N:**

Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri ( këtu e mëposhtë Unifi) , me shkresën nr. 987 prot, datë 21.06.2011 “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a.*”, sqaron se:

1. Unifi Holdings, informon se ka shprehur interesin për të lidhur marrëveshje interkoneksioni me Eagle Mobile sh.a., në Janar të 2011. Në AKEP është depozituar shkresa me nr. 124 Prot. i AKEP, datë 28.1.2011, me të cilin është kërkuar zgjidhja e mosmarrëveshjes së interkoneksionit ndërmjet Unifi Holdings dhe Vodafone Albania sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.
2. Me shkresën nr. 502 Prot., datë 8.02.2011, Eagle Mobile sh.a., i përgjigjet Unifi Holdings, se nuk rezulton të ketë ardhur asnjë shkresë apo kërkesë për interkoneksion nga ky subjekt;

3. Me shkresën e datës 12.04.2011, Unifi Holdings i drejton Eagle Mobile sh.a., “Kërkesë për lidhje marrëveshje interkoneksioni” dhe se mbetet në pritje të diskutimit të të gjithë informacionit teknik e formal që mund të jetë i nevojshëm;
4. Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 1528 Prot., datë 18.04.2011, i përgjigjet Unifi Holdings, se:
  - Do të interkonektohen me operatorët mobile vetëm operatorët alternativë që përmbushin teknikisht kushtin e analizës dhe rrugëzimit në destinacionin e duhur të thirrjeve drejt numrave të portuar pas testimit dhe çertifikimit nga AKEP;
  - Të gjithë operatorët e pa çertifikuar për portabilitetin e numrit do të interkonektohen përmes Albtelecom sh.a., i cili do të analizojë trafikun e operatorëve alternativë dhe do të rrugëzojë në destinacionet e duhura thirrjet drejt numrave të portuar;
  - Në këtë kuadër Eagle Mobile sh.a. është në pritje të përditësimit të kuadrit rregullator dhe RIO-s nga AKEP, në funksion të procesit të portabilitetit të numrave dhe do të shqyrtojë kërkesat për lidhje MI pas përfundimit të këtij procesi;
5. Me shkresën e datës 12.05.2011, Unifi Holdings, i përgjigjet Eagle Mobile sh.a., duke e përsëritur kërkesën për interkoneksion dhe duke e informuar se i përmbush të gjitha kërkesat teknike për analizën dhe rrugëzimin në destinacionin e duhur të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare që përfundojnë në rrjetin efektiv të numrave të portuar.
6. Në përfundim, Unifi, kërkon nga AKEP, që bazuar në argumentet faktikë cituar më sipër, ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 (*neni 50 e në vijim*), Ofertën Referencë të Interkoneksionit të EM, të urdhërojë Eagle Mobile sh.a., të nënshkruajë marrëveshjen e interkoneksionit me Unifi Holdings.
7. Duke qënë se, sipërmarrësit Unifi Holdings Inc Dega në Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a megjithë negociatat dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për nënshkrimin e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, te Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 te Rregullores së Brëndshme,

### **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:

- Jonida GJIKA Kryetar
- Jetmir BRAHA Anëtar
- Donald SHTREPI Anëtar
- Florida ÇELA Anëtar
- Ded JAKAJ Anëtar

3. Të njoftohen palët e interesuara Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a.për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Zamira NURÇE**